

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PROKURIMEVE

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti: “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit”

Kodi Përkatës Në Fjalorin E Përbashkët Të Prokurimit (CPV): Shërbime mirëmbajtje makinash 50112200-5

Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) REF-94914-07-30-2026

Vlera e fondit limit: 1,659,160 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) **lekë pa T.V.SH.**

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe studimit të tregut, fondi limit u përlogarit bazuar në mesataren e ofertave të marra nga ky studim.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

Argumentimi:

Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe neni 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar: Pika 1, Neni 83 Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin Licencë (të vlefshme), kategoria VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, për vendin ku ushtron aktivitetin në përputhje me legjislacionin për lejet dhe licencat, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr. 1546, datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” për ambjentin ku ushtron këtë aktivitet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) apo disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” të ndryshuar si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr. 1546, datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” për ambjentin ku ushtron këtë aktivitet.

Licenca dhe kategoria, e përcaktuar si kriter më sipër është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi:

Kriteri është vendosur duke u bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit të Prokurimit Publik (i ndryshuar), të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 1 dhe 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 LPP, neni 41, pika 3 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

Si dhe nenin 55, pika 4, b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve përkatësisht të ketë:

- **Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) (e vlefshme)**

Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Të gjitha çertifikatat të mësipërme duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë të paktën në datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në :

- nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) si dhe nenin: 44, pika 1 dhe 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar

Ky standard është i nevojshëm pasi ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke qenë se ky standart fokusohet në cilësinë e procesit të riparimit të automjeteve, rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi do të përmbushë/realizojë shërbimet objekt

prokurimi, sipas pritshmërive/specifikimeve teknike të kërkuara. Çertifikimi ISO 9001:2015 vërteton se një kompani që e posedon atë, ka përmbushur standardet e cilësisë sipas atyre ndërkombëtare dhe lidhet drejtpërdrejt me mënyrën se si një kompani/operator ekonomik e zhvillon/përmirëson biznesin e tij në lidhje me përmbushjen e kërkesave të AK

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të punësuar për çdo muaj jo më pak se 3 punonjës, për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të cilët shërbejnë dhe janë në funksion të aktivitetit. Në lidhje me këtë pikë Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë stafin sipas profesioneve të mëposhtme:

- 1 (një) Inxhinier mekanik në rolin e drejtuesit teknik
- 1 (një) Xhenerik
- 1 (një) Elektroauto

Për secilin prej punonjësve në pikën më sipër duhet të paraqitet :

- Çertifikatë/ Diplomë/ Dëshmi kualifikimi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/ private të liçensuara sipas ligjit nr.15/2017 Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar
- Kontrata individuale e punës
- Listëpagesat e punonjësve për 3 (tre) Muajt e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DST. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohej sqarime nga Autoriteti Kontraktor

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën një ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Dokument që vërteton pronësinë, ose huapërdorjen, ose qiramarrjen si më poshtë:

- Dokument që vërteton pronësinë:

- Certifikata e pronësisë, e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose
- Kontrata e shitblerjes ose
- Kontrata e dhurimit ose
- Çdo dokument tjetër, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë
 - *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*
- Kontratë huaje
 - *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*
- Kontratë qiraje

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi, objekt prokurimi është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, të cilat duhet të dërgohen në ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij.

Disponimi minimalisht i 1 (një) ambjenti ku ushtron aktivitetin e tij, lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke krijuar siguri dhe garanci për AK që ofertuesi ka kapacitetet e domosdoshme për të përmbushur me sukses kontratën, në kohë dhe konform specifikimeve teknike të kërkuara. Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë ambient është e lidhur ngushtë me natyrën e kontratës, pasi shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve kërkon ndërhyrje të profesionale dhe të vazhdueshme

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- 1 (një) urë ngritëse (me kapacitet jo më pak se 3.5 Ton)
- 1 (një) linjë kontrolli për sistemin e frenimit
- Pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v
- Pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo)
- Pajisje diagnostikues, të difekteve elektronike në mjete, të paktë 1 (një) copë
- Pajisje për zëvendësimin e vajit të motorrit
- Pajisje për kontrollin dhe testimin e difekteve (xhokove) në sistemin e drejtimit
- Pajisje për kontrollin dhe riparimin e turbinave

Në lidhje me këtë kriter, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Dokumenta që vërtetojnë se këto pajisje i ka në pronësi ose me qira (fatura blerje/ dokumenta zhdoganimi/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ kontratë dhurimi/ çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit do të bëhet gjithashtu dhe kontroll në ambjentet e servisit për disponimin e pajisjeve

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar si dhe nenit 41, pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, objekt prokurimi.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se ambjentet e servisit dhe të parkimit të jenë të survejuara me kamera dhe ruajtje me roje private.

Për plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë dhe kontratë shërbimi për ruajtjen dhe sigurinë fizike me roje private të ambjenteve të servisit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar si dhe nenit 41, pika 4 c dhe ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Ky kriter është vendosur për të garantuar sigurinë fizike të automjeteve që do të dorëzohen për mirëmbajtje, riparim ose parkim gjatë zbatimit të kontratës. Duke qenë se automjetet përbëjnë pasuri me vlerë të konsiderueshme, është e nevojshme që ambientet e servisit dhe të parkimit të jenë të pajisura me sistem survejimi me kamera dhe të sigurohen me shërbim roje private, me qëllim parandalimin e vjedhjeve, dëmtimeve apo ngjarjeve të tjera që mund të cenojnë integritetin e tyre.

- **2.3.7** Operatori Ekonomik ofertues duhet të deklarojë se në rastet kur mjeti pëson defekt dhe nuk është në gjendje të lëvizshme, merr përsipër me shpenzimet e veta ta transportojë mjetin me karrotrec deri në servis.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar si dhe nenit 41, pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Kjo kërkesë synon të garantojë vijimësinë e shërbimit dhe eliminimin e vonesave në riparimin e mjeteve. Për më tepër, duke qenë se mjetet do të përdoren për përmbushjen e funksioneve të institucionit, është e nevojshme që çdo situatë defekti të trajtohet në kohë dhe me përgjegjësi nga operatori ekonomik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

Operatorët Ekonomikë duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26 pika 6, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Riparimi i automjeteve objekt i kësaj kontrate do të shoqërohet me këto dokumente nga OE:

- ✓ Faturë tatimore të fiskalizuar për shërbimin e kryer
- ✓ Situacioni i riparimeve të kryera për çdo automjet
- ✓ Procesverbalin e kontrollit(situacion) riparimit të kryer
- ✓ Çertifikatë garancie për riparimin e mjetit të kryer

AFATI: Riparimi i mjeteve të mësipërme do të kryhet brenda 60 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

- a) Pjesët e këmbimit që do të përdoren për kryerjen e shërbimeve do të jenë të reja dhe origjinale për çdo tip automjeti në përputhje me specifikimet teknike të prodhuesit të automjetit
- b) Pjesët e këmbimit të jenë të identifikueshme nëpërmjet dokumentacionit të prodhuesit, dhe të jenë në përputhje me standardet evropiane të zbatueshme, kur këto ekzistojnë.
- c) Garancia e riparimeve do të jetë jo më pak se 6 muaj nga lëshimi i çertifikatës së garancisë

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike, për mallin objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Njësia e Prokurimit